



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 428/11 prot.

Tiranë, më 16.10.2019

VENDIM

Nr.94, datë 16.10.2019

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 75, DATË 10.06.2019, NË
QENDRËN E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE VLORË

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Nr. 75, datë 10.06.2019 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

KONSTATOVA SE:

Bazuar në Vendimin nr. 36, datë 17.04.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë”, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 75, datë 10.06.2019, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në këtë institucion.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin paralajmërues nr. 75, datë 10.06.2019, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në

institucionet në varësitë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, në të cilin është vendosur:

- “2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, të dërgojë formularët e përshkrimit të punës, pranë Departamentit të Administratës Publike, për të marrë edhe miratimin e njësisë përgjegjëse dhe më tej t'i depozitojë ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.*
- 3. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, të përcjellë kërkesën për nxjerrjen e aktit të krijimit të Komisionit të Ristrukturimit, sipas dispozitave të Kreut VIII, “Transferimi në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt, me qëllim zbatimin e urdhrit të Kryeministrit nr. 66, datë 04.05.2015, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë.*
- 4. Departamenti i Administratës Publike të mbikëqyr realizimin e procesit të ristrukturimit në këtë institucion dhe të informojë Komisionerin në lidhje me veprimet e kryera.*
- 5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.”*

Në përfundim të afatit të lënë për zbatimin e këtij vendimi, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë, ka informuar Komisionerin mbi masat e marra, duke bashkëngjitur edhe praktikën shkresore që materializon zbatimin e tij.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, si dhe në detyrat e lëna për Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë, në përmbajtjen e vendimit paralajmëruar për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, konstatohet se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në zbatim të pikës 2 të vendimit, sipas dokumentacionit të dërguar nga njësia e burimeve njerëzore në rrugë elektronike më datë 01.10.2019, vërej se, institucioni i mbikëqyrur me shkresën nr. 196 prot., datë 11.07.2019, me objekt: “Kërkesë për miratimin e formularëve të përshkrimit të punës” i është drejtuar njësisë përgjegjëse Departamentit të Administratës Publike për të marrë miratimin e formularëve të përshkrimeve të punës. Në

vijim, Departamenti i Administratës Publike i është përgjigjur institucionit me shkresën e datës 30.08.2019, duke evidentuar faktin se formatet e përshkrimit të punës, janë hartuar duke respektuar standardet e përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucioneve të pavarura”*, të ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 31.05.2017, *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*, të DAP, por rubrika të veçanta të formatit duhet të rishikohen nga ana e institucionit, sipas sugjerimeve të dhëna nga njësia përgjegjëse.

Në zbatim të pikës 3 të vendimit paralajmërues, me shkresën nr. 4087/2 prot., datë 22.07.2019, *“Kthim përgjigje”*, dërguar Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë, dhe për dijeni Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, ka parashtruar sa më poshtë vijon:

Nga praktika shkresore rezulton se, QTTB Vlorë i është drejtuar njësisë përgjegjëse DAP përmes shkresës nr. 181, datë 18.06.2019, me objekt *“Kërkesë për nxjerrjen e aktit të krijimit të Komisionit të Ristrukturimit”*, sipas dispozitave të Kreut VIII, *“Transferimi në shërbimin civil”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt, me qëllim zbatimin e Urdhrit të Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 04.05.2015, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë”*, si dhe në zbatim të pikës 3, të Vendimit paralajmërues nr. 75, datë 10.06.2019, të Komisionerit.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, nga ana e Departamentit të Administratës Publike është nxjerrë Urdhri nr. 46, me nr. 3724/2 prot., datë 27.06.2019.

Në vijim, gjatë ndjekjes së procesit të ristrukturimit në institucion, nga ana e anëtares së Komisionit të Ristrukturimit është konstatuar dokumentacioni, i cili vërteton kryerjen dhe përfundimin e procesit të ristrukturimit të QTTB Vlorë, sipas Urdhrit nr. 133/1, datë 22.10.2015, *“Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë”*, të Departamentit të Administratës Publike, dokumentacion për të cilin KMSHC gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nuk ka marrë dijeni nga institucioni i mbikëqyrur (*dokumentacioni gjendet bashkëlidhur shkresës së sjellë nga DAP*).

Sipas këtij dokumentacioni, rezulton se, përmes Urdhrit nr. 133/1, datë 22.10.2015, *“Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë”*, të njësisë përgjegjëse DAP, strukturat përgjegjëse kanë përfunduar procedurën e ristrukturimit të QTTB Vlorë, dhe në përfundim të saj kanë dalë edhe aktet administrative përkatëse, në përputhje me kërkesat e ligjit për

shërbimin civil. Ky informacion në lidhje me procedurën dhe aktet e dala në përfundim të saj janë përcjellë pranë Komisionerit, me shkresën nr. 193 prot., datë 02.07.2019 me objekt: “Informacion”, edhe nga institucioni Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë.

Për pasojë, nxjerrja e Urdhrit nr. 46, me nr. 3724/2 prot., datë 27.06.2019, për të njëjtën procedurë administrative, nuk mund të prodhojë asnjë efekt juridik, referuar nenit 95, të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të ristrukturimit është realizuar. Në këto kushte, Departamenti i Administratës Publike ka vijuar me anulimin e Urdhrit nr. 46, me nr. 3724/2 prot., datë 27.06.2019, të tij, të materializuar në Vendimin nr. 50 prot., datë 22.07.2019, sipas parashikimeve të nenit 113, e vijues të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar.

Për sa u parashtrua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit të mbikëqyrur, janë zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues Nr. 75, datë 10.06.2019, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së Administrimit të shërbimit civil në institucionet në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë.*”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 75, datë 10.06.2019, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur dhenjësisë përgjegjëse Departamenti i Administratës Publike duke zbatuar rekomandimet e Vendimit nr. 75, datë 10.06.2019.

3. Për këtë vendim të njoftohet Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë, Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA